

# ZBULUESIT

**Viti 1 - Tremujori 1**

**Programi Bazë**



# NJË MESAZH NGA KRIS SMOLL

Të dashur drejtues,

Jemi të entuziazmuar që këtë tremujor kemi mundësinë të shohim Perëndinë i cili zbulon planin e Tij të mrekullueshëm e shpengues në librin e Zanafillës. Gjatë gjithë aventurës sonë në këtë libër të mrekullueshëm, plot me të vërteta të jashtëzakonshme, ne ju inkurajojmë të përgatiteni çdo javë dhe të drejtoni përmes lentes së një botëkuptimi biblik:

**Kupto si duhet:** Një pasazh nga Shkrimi për të studiuar.

**Mendo si duhet:** Një varg nga Shkrimi për të medituuar gjatë javës.

**Vepro si duhet:** Sfidat për ta vënë në zbatim Fjalën e Perëndisë.

Ndihuni si duhet: Rezultatit i zbatimit të mësimin dhe të pasurit e një botëkuptimi biblik. Kur ne dishepullojmë përmes 4 pikave 'si duhet', ne i trajnojmë nxënësit që të përpunojnë si duhet me të vërtetën periodat e mira dhe të vështira të jetës, gjë që i ndihmon të veprojnë dhe të ndihen si duhet përpara Perëndisë së tyre.

Do të doja të inkurajoja ata që janë të rinj në mësimdhënie që të lidhen me mësues me eksperiencë; të kërkojnë ndihmën dhe udhëheqjen e tyre. Nëse ke eksperiencë, kupto që je bekim i madh për skuadrën; merr kohë për të inkurajuar dhe trajnuar anëtarët e skuadrës tënde. Njohuria jote, aftësitë dhe dhuntitë e tua, shumëfishohen kur investon te të tjerët.

Ne sinqerisht presim me padurim të shohim se si Perëndia do të transformojë jetët e fëmijëve teksa i inkurajojmë të zbulojnë të vërtetën në Fjalën e Perëndisë dhe ta zbatojnë në jetët e tyre, në periodat që do të vijjnë.

Kris Smoll

Drejtoreshë ekzekutive e *Discovery Land Global*

# TABELA E PËRMBAJTJES

## Viti 1 – Tremujori 1

Të kuptojmë kurikulën.....	4
Përmbledhja e tremujorit.....	9
Mësimi 1: Perëndia krijon botën. ....	12
Mësimi 2: Perëndia krijoi Adamin dhe Evën. ....	21
Mësimi 3: Mëkati hyn në botë. ....	30
Mësimi 4: Kaini mëkatoi kundër Abelit. ....	40
Mësimi 5: Noeu ndërton një arkë. ....	49
Mësimi 6: Perëndia përmyt botën. ....	57
Mësimi 7: Ndërtohet kulla e Babelit. ....	66
Mësimi 8: Abrami dhe Loti ndajnë tokën. ....	75
Mësimi 9: Perëndia bën një besëlidhje me Abram. ....	84
Mësimi 10: Abrahami dhe Agari linden Ismaelin. ....	93
Mësimi 11: Abrahami dhe Sara linden Isakun. ....	102
Mësimi 12: Dita e përsëritjes .....	109
<b>Shtojca</b>	
Mësim tematik: Bibla është e vërtetë.....	112
Loja e përsëritjes para shërbesës.....	120
Lojërat e fundit të përsëritjes .....	123
Libri pa fjalë – T'u prezantojmë fëmijëve ungjillin .....	128
Falënderimet dhe lejet .....	130

# TË KUPTOJMË KURIKULËN

## Pasqyrë e përgjithshme

Kurikula është hartuar për të qenë ARGËTUESE, PËRFSHIRËSE dhe EFEKTIVE, në mënyrë që t'i motivojë fëmijët ta njohin dhe ta duan Perëndinë. Ajo është strategjike dhe e qëllimshme, dhe merr parasysh zhvillimin frymëror të fëmijëve të moshës nga gjashtëmuajsh deri në 9 vjeç.

Kurikula u hartua për t'i mësuar nxënësit në lidhje me:

1. **Biblën:** pamjen e përgjithshme të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re si një të vetme, zbulesën e unifikuar të së vërtetës së Perëndisë për ne.
2. **Ungjillin e Jezusit:** shpëtimin me anë të hirit përmes besimit siç paraqitet në të gjithë Biblën.
3. **Bazat e krishterimit:** transformimin e jetës përmes lutjes, adhurimit, ungjillëzimit, mësimit përmendsh të Shkrimit, pagëzimit, Darkës së Zotit, të dhjetës, bashkësisë, shërbesës, misionit etj. (Listën e plotë sipas grup-moshave, mund ta gjeni në Hartën e gjurmuesit).

## Mësimet bazë mbështeten në strukturën:

KUPTO SI DUHET → MENDO SI DUHET → VEPRO SI DUHET → NDIHU SI DUHET

<b>Kupto si duhet:</b>	Një pasazh kyç nga Shkrimi – 2 e Timoteut 2:15
<b>Mendo si duhet:</b>	Një varg kyç nga Shkrimi për të medituar gjatë javës – Psalmi 1:2
<b>Vepro si duhet:</b>	Sfida për të vënë në praktikë Fjalën e Perëndisë – Jakobi 1:22
<b>Ndihu si duhet:</b>	Rezultati i zbatimit të mësimit dhe të të pasurit e një botëkuptimi biblik në vend të një pikëpamjeje laike – Psalmi 23

## Drejtuesit

Çdo klasë ka zakonisht tre drejtues: Mësuesin kryesor, Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe Bariun.

**Mësuesi kryesor:** Është përgjegjës për mësim të qëndrueshëm biblik, që tërheq vëmendjen e nxënësve dhe krijon një rritje frymërore për ta duke ndjekur kurikulën, si dhe siguron udhëheqje për nxënësit dhe vullnetarët gjatë takimit.

**Drejtuesi i kohës së zbulimit:** Është përgjegjës për udhëheqjen e Kohës së zbulimit, një aktivitet prej 15 minutash, i cili është edukativ, energjik, ndërveprues dhe ka në bazë ekipin, siç citohet në kurikulum.

**Bariu:** Është përgjegjës për nxitjen dhe trajnimin e nxënësve gjatë gjithë takimit, duke përfshirë lidhjen e tyre me një mik dhe ndihmon ata që vijnë për herë të parë, të ndihen të mirëpritur.

### **Këshilla për drejtuesin**

Të gjithë drejtuesit duhet të qëndrojnë gjatë gjithë mësimit në klasë duke u angazhuar me nxënësit dhe duke i ndihmuar ata sipas nevojës.

Për grupe më të vogla, Drejtuesi i kohës së zbulimit dhe Bariu mund të jenë i njëjti person.

## **Pasqyra bazë e programit**

Programi përbëhet nga pesë elemente:

1. Loja e përsëritjes
2. Adhurimi
3. Koha e zbulimit
4. Mësimi nga Bibla
5. Loja e fundit e përsëritjes

Këto pjesë janë të lidhura fort me njëra-tjetrën, të cilat krijojnë një ambient mësimi me kohë të plotë, ku çdo minutë është e rëndësishme dhe çdo nxënës përfshihet për të mësuar pikat kryesore të mësimit apo një objektivi të Hartës së gjurmuesit.

### **Program i sugjeruar**

-: 20 Vullnetarë të gatshëm dhe të përgatitur për të mirëpritur nxënësit teksa mbërrijnë

-: 15 Loja e përsëritjes

: 00 Adhurimi

: 15 Koha e zbulimit

: 30 Mësimi nga Bibla

: 60 Loja e fundit e përsëritjes

: 65 Marrja e nxënësve nga prindërit

## **Loja e përsëritjes**

### **Këshilla për drejtuesin**

Drejtuesit të cilët nuk janë duke i mirëpritur nxënësit ndërsa hyjnë në klasë, duhet t'i ndihmojnë dhe t'i nxisin ata gjatë Lojës së përsëritjes. P.sh, Duke brohoritur!

Sigurohu që vizitorët të ndihen të mirëpritur dhe përpiku t'i bashkoh me një mik të ri nga klasa jote.

Loja e përsëritjes është krijuar që të jetë argëtuese dhe energjike, për të rishikuar mësimet dhe temat e mëparshme nga Harta e gjurmuesit. Koha shfrytëzohet më së miri teksa fëmijët vijnë dhe për prindërit është gjëja e parë që shohin!

Udhëzimet për lojën e përsëritjes gjenden te shtojca.

## Adhurimi

### Këshilla për drejtuesin

Inkurajo nxënësit të jenë të respektueshëm dhe të marrin pjesë duke bërë lëvizjet e caktuara të këngëve, dhe/ose duke qëndruar thjesht në këmbë në shenjë respekti. Drejtuesit duhet të parandalojnë dhe të korrigjojnë çdo lloj sjellje shqetësuese.

Adhurimi është hartuar për të:

- paraqitur mësimin e ditës
- mësuar se çfarë është adhurimi
- modeluar adhurimin autentik
- nxitur pjesëmarrjen në adhurim

Në një javë të zakonshme, adhurimi përmban dy ose tre këngë. Kurikula e adhurimit gjendet te shtojca.

## Koha e zbulimit

Aktivitetet e Kohës së zbulimit (KZ) janë krijuar për t'i angazhuar dhe sfiduar nxënësit përmes mëimit praktik. Përmes KZ-së, ata do të përjetojnë një emocion ose një reagim që do t'i ndihmojë të lidhen personalisht me mësimin e Biblës. Ndonjëherë aktiviteti i KZ-së do të përdoret për të krijuar një "pamje të paharrueshme" të mëimit biblik, siç mund të jetë një ndjenjë, një aromë apo një shije e diçkaje te rrëfimi i Biblës.

### Këshilla për drejtuesin

Sigurohu që të kuptosh paraprakisht se si KZ-ja lidhet me mësimin dhe se si do të funksionojë aktiviteti. Nëse nuk je i sigurt, kontakto drejtuesin e shërbesës. Dhe mbaj mend, drejto me entuziazëm; KZ-të janë pjesë emocionuese e takimit të fëmijëve!

## Mësimi nga Bibla

Mësimi i Biblës është një përvojë e udhëhequr nga mësuesi, i cili e bën Biblën të gjallë për nxënësit. Ungjilli është i ndërthurur në çdo mësim. Atje ka një skicë të Shkrimit për të ndihmuar në udhëheqjen e mëimit:

**Kreu i seksionit:** Ky informacion është vetëm për mësuesin (jo për dialog).

**Lexo:** Shkrime nga Bibla për t'ia lexuar nxënësve me zë të lartë.

**Përmbledhje:** Pasi të keni lexuar pjesën nga Shkrimi, merr kohë për t'iu shpjeguar se çfarë do të thotë ajo pjesë. "Përmbledhja" shpesh bën një pyetje, përcakton fjalët kyç, ose rishpreh tablonë e asaj që lexuat, në nivelin e një fëmije.

**Parafrazim:** Kjo do të thotë se nuk keni nevojë ta lexoni pjesën drejtpërdrejt nga Bibla (për shkak të kohës, gjatësisë së vargjeve, ose për shkak se mbulon një temë të vështirë që duhet të bëhet më e përshtatshme për fëmijët). Ju lutemi, mos e lexoni tekstin e parafrazuar drejtpërdrejt nga kurikula.

### **Hapat e sugjeruar për përgatitjen e mësimit nga Bibla:**

1. Lutu për drejtimin dhe udhëheqjen e Perëndisë! Gjithashtu kalo kohë duke u lutur për nxënësit e tu emër për emër.
2. Lexo Shkrimin nga Bibla jote – nënvizo pikat kryesore! Kjo kurikul është hartuar mbi themelin e Fjalës së Perëndisë dhe mësimit rreth të vërtetës së Tij nga Fryma e Shenjtë. Është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit të lexojnë fragmente nga Shkrimi, përpara se të lexojnë skicën e mësimit nga Bibla. Kurikula mund të përmbajë gabime, por Bibla është e pagabueshme.
3. Lexo pyetjet shqyrtuese të mësimit!
4. Lexo kurikulën!
5. Planifiko mësimin! Sigurohu që të përdorësh kalimin e aktivitetit të KZ-së për të prezantuar dhe/ose theksuar pikën “Vepro si duhet” të mësimit.
6. Bëje mësimin më të gjallë duke përdorur mjete, figura apo veprime, si dhe duke përdorur ide krijuese nga kurikula.
7. Praktiko mësimin në mënyrë që “t’i jepni jetë Biblës”, duke pasur emocion në zë dhe kontakt të mirë me sy.
8. Mësuesit duhet t’i kenë Biblat e hapura gjatë gjithë mësimit, në mënyrë që nxënësit të dinë se ngjarja vjen nga Bibla. Të gjithë nxënësit duhet t’i hapin Biblat te pasazhi nga Shkrimi siç i drejton mësuesi (shih seksionin “Gjejeni” në prezantimin e mësimit). (Nxënësit më të vegjël mund të kenë nevojë për ndihmë.) Për shkak të kohës së limituar dhe vlerës që i japim përdorimit të Biblave nga nxënësit, ju lutemi mos e lexoni mësimin nga një libër me histori biblike.

## **Loja e fundit e përsëritjes**

Lojërat e thjeshta të përsëritjes i gjeni te shtojca e kurikulës. Drejtuesit e kohës së zbulimit ose Barinjët drejtojnë lojën e përsëritjes ndërsa prindërit janë duke marrë fëmijët. Mësuesi kryesor shpërndan etiketat shpërblyese dhe lidhet me prindërit.

### **Këshilla për drejtuesin**

Shpërbleji pyetjet përsëritëse! Mund t’i kthesh në pyetje E vërtetë/E gabuar ose në pyetje me alternativa, si të përshtaten më mirë për moshën dhe nivelin e klasës.

## Materialet për klasën

Për mësimin iu jepen materialet e mëposhtme:

- Kronologjia e Biblës
- Libri pa fjalë
- 12 vargjet kyç
- Fletushka *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*
- Broshura *E beson apo jo?*
- Libër shënuesi *Unë besoj*
- Broshura *Çfarë ndodh më pas?*
- Postera me librat e Dhiatës së Vjetër dhe të Re
- Etiketat shpërblyese
- Posterit *Ndihuni si duhet*
- Harta e kohëve të Biblës

## Etiketat shpërblyese

Etiketat shpërblyese mund të fitohen nga nxënësit gjatë mësimin dhe të shpenzohen më pas në Tregun e zbulimit.

### Kursi i këmbimit:

- 3 Marrja e Biblave me vete (për fëmijët më të vegjël)/ Përdorimi i Biblave (për më të rriturit)
- 2 Pjesëmarrja aktive në klasë
- 1 Shfaqja e frytit të Frymës
- 1-5 Aktivitetet e Kohës së zbulimit (specifikuar në kurikul)
- 5 Plotësimi i Thesareve të gjurmuesit dhe kthimi i kuponit
- 10 Vizitori dhe miku që sjell vizitorin

## Thesaret i gjurmuesit

Thesaret e gjurmuesit janë letra shumëngjyrëshe, të përshtatshme për fëmijët dhe familjet që t'i marrin në shtëpi. Është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar bashkëpunim me prindërit. Thesaret i gjurmuesit i edukon për atë që po mësojnë fëmijët dhe i sfidon ta aplikojnë mësimin në shtëpi gjatë javës. Pasi të plotësohet aktiviteti sfidues si familje, nxënësit mund të kthejnë kuponin te mësuesi dhe të marrin pesë Etiketa shpërblyese.



# PËRMBLEDHJA E TREMUJORIT

## Viti 1 – Tremujori 1

Mirë se vini! Këtë tremujor, udhëtimi ynë entuziazmuës gjatë gjithë Biblës, nis me librin e Zanafillës. Ndërsa studiojmë këtë periudhë të jashtëzakonshme historike, do të shohim se si zbulohet plani i Perëndisë. Nga krijimi i botës e deri te lindja e birit të premtuar të Abrahamit, Isakut, ky studim shqyrton natyrën tonë mëkatore, që mund të pastrohet vetëm nga Shpëtimtari që Perëndia do të dërgonte. Lutja jonë është që përmes këtij studimi, nxënësit tuaj do të besojnë në Krishtin dhe do të rriten në hirin dhe njohjen e Tij.

Mësimi i parë na çon pikërisht te fillimi i javës së krijimit. Perëndia na ka treguar rendin në të cilin ka krijuar gjithçka. Në ditën e parë, Ai krijoi dritën dhe e ndau atë nga errësira; në ditën e dytë, qiellin; ditën e tretë, tokën, detet dhe bimësinë; ditën e katërt, diellin, hënën dhe yjet; ditën e pestë, krijesat e detit dhe zogjtë; ditën e gjashtë, kafshët e tokës, dhe në mënyrë unike njeriun sipas shëmbëlltyrës së Vet; dhe në fund, në ditën e shtatë, Ai pushoi. Rezultatet e krijimit të Perëndisë janë një dëshmi e fuqishme që Ai ekziston dhe se Ai na do; dhe nisur prej kësaj, ne duhet të besojmë gjithmonë se Perëndia e krijoi botën.

Pastaj do të shohim më nga afër ditën e gjashtë të krijimit për të mësuar se si Perëndia e formoi njeriun e parë. Perëndia na thotë se Ai mori pluhurin nga toka, i dha formën e një njeriu dhe hukati frymë jete tek Adami, kështu ai u bë qenia e parë njerëzore. Ai i dha Adamit një shtëpi të jashtëzakonshme në Kopshtin e Edenit, një punë për të bërë dhe ushqim për të ngrënë. Pastaj Perëndia bëri një grua si ndihmësen e tij – direkt nga brinja e Adamit. Perëndia e bashkoi Adamin dhe Evën në një tjetër nga krijimet e Tij të veçanta – martesë – dhe u tha të kishin fëmijë, që toka të mbushej me njerëz. Nga ky plan i saktë dhe i qëllimshëm, kuptojmë se Perëndia na krijoi.

Pasi Perëndia krijoi Adamin dhe e vendosi në kopshtin e Edenit për të punuar dhe për t'u kujdesur për të, Ai i dha një urdhërim. Perëndia i tha Adamit të mos hante nga pema e njohjes të së mirës dhe së keqes. Perëndia i tha që, nëse Adami do të hante nga ajo pemë, do të vdiste. Megjithatë, në vend që ta dëgjonte Perëndinë dhe t'i bindej, Adami dëgjoi gruan e tij, Evën, e cila ishte mashtruar nga gjarpri i quajtur Satan. Kështu, edhe Adami edhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, dhe kryen mëkatën e parë, që solli vdekje dhe vuajtje në botë. Por mëkati i njeriut nuk përfundoi aty. Siç na tregon edhe Bibla, gjithsecili prej nesh, lindur nga Adami dhe Eva, kemi treguar mosbindje të marrë ndaj Perëndisë. Për këtë arsye, tani mund të kuptojmë se kemi mëkatuar!

Pasi Adami dhe Eva mëkatuan dhe u dëbuan nga kopshti i Edenit, Perëndia u dha një familje. Fatkeqësisht, të gjithë fëmijët lindën me natyrën mëkatore të prindërve të tyre.

Djali i tyre, Kaini, u bë punues toke dhe djali tjetër, Abeli, u bë bari. Mënyra si e jetonin jetën shfaqte dallime të mëdha. Oferta e çmuar e Abelit me të parëlindurit e kopesë dhe yndyrën e tyre, tregonte se ai jetonte siç i pëlqente Perëndisë, përmes besimit. Oferta jo e çmuar e Kainit ishin frutat e tokës dhe tregonte mënyrën si ai jetonte, pra, pa besim. Për shkak se Abeli jetonte siç i pëlqente Perëndisë, me besim, ai u deklarua i drejtë dhe u bë pjesë e heronjve të besimit. Për shkak se Kaini jetoi pa besim, u ndëshkua për mëkatin e tij dhe duhej të endej nëpër tokë, në vend që të ishte punues i saj. Për shkak të kësaj, ne mund ta dimë me siguri se Perëndia e urren mëkatin.

Familja e Adamit dhe Evës vazhdoi të rritej, dhe kështu patën një pasardhës të quajtur Noe. Në kohën e Noeut, Perëndia pa botën dhe lëngoi për shkak të ligësisë së madhe që pa. Fatmirësisht, Ai pa gjithashtu që Noeu besonte në Të, prandaj Ai ia shfaqti planin e Tij atij – një plan për të shkatërruar botën përmes një përmbytjeje. Perëndia i tha Noeut të ndërtonte një arkë që do të shpëtonte familjen e tij dhe dy nga çdo krijesë e gjallë. Noeu u bind dhe ndërtoi arkën – që ishte e vetmja mënyrë shpëtimi për të dhe familjen e tij. Arka është një shembull i mënyrës se si Jezusi mund të na shpëtojë nga ndëshkimi për mëkatin tonë.

Rreth 100 vite pasi Perëndia ia shfaqti planin e Tij Noeut, Ai dërgoi përmbytjen. Çifte nga të gjitha llojet e zogjve dhe kafshëve të tokës, si dhe Noeu e familja e tij, hipën në arkë. Pastaj Perëndia mbylli derën dhe ata ishin të sigurt dhe të mbrojtur nga përmbytja. Rreth një vit më vonë, Noeu, familja e tij dhe zogjtë e kafshët që kishin qenë në arkë, zbritën në tokë të thatë. Perëndia i bëri një premtim Noeut: Ai nuk do ta shkatërronte kurrë më tokën me përmbytje. Shenja e premtimit të Perëndisë ishte ylberi. Perëndia ishte besnik. Ai i shpëtoi ata që ishin në arkë nga përmbytja. Ashtu si ata, ne që kemi besuar në Jezusin jemi të sigurt dhe të shpëtuar nga shkatërimi i mëkatis. Ngjarja e Noeut dhe e përmbytjes na mëson secilit prej nesh premtimin se Jezusi mund të na shpëtojë nga mëkati ynë.

Noeu dhe familja e tij iu bindën Perëndisë duke bërë fëmijë që të mbushnin tokën. Megjithatë, shumë vite më vonë, pasardhësit e tyre vendosën ta jetonin jetën siç u pëlqente atyre dhe jo siç i pëlqente Perëndisë. Ata ndërtuan një qytet, sepse donin të bënin emër dhe nuk donin të shpërndareshin nëpër botë. Kështu ndërtuan një kullë të lartë në qytet, sepse donin të arrinin qiejt. Zgjidhja e Perëndisë për këtë mosbindje ishte ngatërimi i gjuhëve të tyre dhe shpërndarja nëpër të gjithë botën. Nga ngjarja e kullës së Babelit mësojmë se duhet t'i bëjmë gjërat gjithmonë siç i pëlqen Perëndisë dhe jo siç na pëlqen neve.

Plani i Perëndisë vazhdoi me një njeri të quajtur Abram. Perëndia i tha Abramit të linte vendin e tij, popullin e tij dhe shtëpinë e babait të tij, e të shkonte në një vend që Perëndia do t'i tregonte. Perëndia i premtoi gjithashtu Abramit se do të ishte një bekim dhe se do të merrte bekime. Meqenëse Abrami kishte besim te Perëndia, ai iu bind

dhe shkoi. Mori edhe gruan e tij, Sarain e nipin e tij, Lotin. Kur arritën në këtë vend të ri, të quajtur Kanaan, ndodhën telashe. Si Abrami, ashtu edhe Loti kishin tufa dhe kope të mëdha, të cilat shkaktuan konflikt midis barinjve të tyre. Toka nuk do t'i mbante të dy nëse do të jetonin së bashku, kështu që Abrami i dha Lotit të zgjidhte se cilën tokë të merrte. Loti zgjodhi me egoizëm atë që dukej si toka më e mirë dhe Abrami mori pa egoizëm atë që kishte mbetur. Altruizmi i Abramit tregoi dashurinë e tij për Perëndinë dhe për Lotin. Perëndia e bekoi Abramin duke i dhënë të gjithë vendin atij dhe familjes së tij përgjithmonë. Kjo tokë një ditë do të quhej Izrael. Shembulli i Abramit dhe besnikëria e Perëndisë na inkurajojnë ta duam Perëndinë dhe të tjerët.

Pasi Abrami arriti në Kanaan, Perëndia i foli përmes një vizioni dhe i shpjegoi më tepër rreth premtimit të Tij të veçantë, të quajtur besëlidhje. Edhe pse Abrami ishte i vjetër dhe nuk kishte fëmijë, Perëndia i premtoi se një bir do të vinte nga vetë trupi i tij. Ai i tha gjithashtu Abramit se do të kishte po aq pasardhës sa ka yje në qiell. Këtyre pasardhësve do t'u jepej toka e Kanaanit për të jetuar në të. Por, para kësaj, ata do të skllavëroheshin në një vend të huaj dhe do të keqtrajtoheshin për katërqind vite. Pas kësaj, ata do të largoheshin nga ai vend me të mira të shumta. Ashtu si Perëndia ia premtoi të gjitha këto Abramit, Ai u premton jetë të përjetshme edhe atyre që besojnë në Birin e Tij, Jezusin, për të na shpëtuar nga mëkati. Abrami besoi në atë që Perëndia i kishte premtuar. Besofshim edhe ne gjithmonë në premtimet e Perëndisë!

Abrami ishte 85 vjeç dhe ende nuk kishte fëmijë. Në vend që të priste me durim Perëndinë që të mbante premtimin e Tij, Sarai e bindi Abramin të kishte një djalë me shërbëtoren e saj egjiptase, Agarin. Agari lindi djalin e Abramit; ai u quajt Ismael. Sapo Agari mbeti shtatzënë, lindi konflikti mes saj dhe Sarait. Ky konflikt ishte pasojë e mungesës së durimit të Abramit dhe Sarait për t'u mbështetur te Perëndia. Perëndia i tha Abramit se Ismaeli nuk ishte biri i premtuar. Për shkak të kësaj, ne mësojmë të mbështetemi me durim te Perëndia për gjithçka.

Perëndia ua ndryshoi emrat në Abraham dhe Sara, dhe kur Abrahami ishte 100 vjeç dhe Sara 90, ajo lindi një djalë të quajtur Isak. Konflikti mes Agarit dhe Sarës u shtua, dhe Abrahamit iu desh të largonte Agarin dhe birin e tij të dashur Ismael – një tjetër pasojë tragjike e të mos priturit me durim në Perëndinë. Pavarësisht padurimit të Abrahamit dhe Sarës, Perëndia e mbajti premtimin e Tij dhe vazhdoi planin për të sjellë Jezusin që të na shpëtonte nga mëkati ynë. Saga e larmishme e familjes së Abrahamit fillon me ne, duke u mbështetur me durim te Perëndia për gjithçka.

Ndërsa i afrohem fundit të tremujorit, marrim një ditë për të kujtuar dhe festuar gjithçka që Perëndia na ka mësuar përmes studimit të Fjalës së Tij. Tremujorin e ardhshëm do të rikthehem te Dhiata e Re për të mësuar se si u bë realitet premtimi i Perëndisë për një Shpëtimtar. Perëndia të bekoftë për shërbesën e përlulur ndaj Tij!

# MËSIMI 1

## Zanafilla 1:1 - 2:3

<b>Kupto si duhet:</b>	Perëndia krijon botën.
<b>Mendo si duhet:</b>	“Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe token.” Zanafilla 1:1
<b>Vepro si duhet:</b>	Unë do të besoj se Perëndia krijoi botën.
<b>Ndiu si duhet:</b>	Unë mund të ndihem i gëzuar për shkak se Perëndia krijoi botën.

## PËRGATITU!

**Krijimi i Perëndisë është një dëshmi e fuqishme, që tregon se Ai ekziston dhe se Ai na do. Puna e duarve të Perëndisë na kujton padyshim se Ai e krijoi botën. Kjo e vërtetë thelbësore na inkurajon t’i ndërtojmë me besim jetët tona mbi Të dhe mbi Fjalën e Tij. Këtë javë, le të kalojmë kohë duke adhuruar Perëndinë për madhështinë e Tij! Pastaj, kur t’i kemi zemrat me këtë qëndrim adhurimi, le të përgatitemi për të shërbyer dhe për t’ua dhënë këtë të vërtetë nxënësve tanë.**

**Lutu:** Lutu për secilin nxënës në klasën tënde. Lutu që Perëndia t’u lejojë të kërkojnë e kuptojnë madhështinë e Perëndisë sonë këtë javë, ndërsa mësojnë se Perëndia krijoi botën. Lutu gjithashtu që do ta kujtojnë këtë mësim ndërsa rriten, që të mund të kenë biseda me bazë biblike për sa i përket krijimit.

**Lexo:** Zanafilla 1:1 – 2:3

### **Kupto si duhet: Perëndia krijon botën**

Mësimi i parë na çon pikërisht te fillimi i javës së krijimit. Perëndia na ka treguar rendin në të cilin ka krijuar gjithçka. Në ditën e parë, Ai krijoi dritën dhe e ndau atë nga errësira; në ditën e dytë, qiellin; ditën e tretë, tokën, detet dhe bimësinë; ditën e katërt, diellin, hënën dhe yjet; ditën e pestë, krijesat e detit dhe zogjtë; ditën e gjashtë, kafshët e tokës, dhe në mënyrë unike njeriun sipas shëmbëlltyrës së Vet; dhe në fund, në ditën e shtatë, Ai pushoi. Rezultatet e krijimit të Perëndisë janë një dëshmi e fuqishme që Ai ekziston dhe se Ai na do; dhe nisur prej kësaj, ne duhet të besojmë gjithmonë se Perëndia e krijoi botën.

# BËHU GATI!

## Shënimet e mësuesit kryesor:

- Nxënësit pyesin shpesh: “Kush e krijoi Perëndinë dhe si e di ti që Ai është i vërtetë?” Ky mësim është një përgjigje shumë e bukur e këtyre pyetjeve. Vetëm një Perëndi i fuqishëm e i gjithëdijshëm mund të krijojë një univers që punon në mënyrë të përsosur!
- Ju lutem, kujtoni se ne u mësojmë nxënësve ditët e krijimit nga një pikëpamje bazike, fjalë për fjalë. Çështja kryesore që duam t’u japim atyre me vete është që Perëndia krijoi botën.
- Dy faqe të mira interneti për krijimin janë: [www.answeringenesis.org](http://www.answeringenesis.org) dhe [www.icr.org](http://www.icr.org)

**Shënim i veçantë për këtë mësim:** Shumica e nxënësve janë mësuar ose do të mësojnë se bota u zhvillua rastësisht përmes evolucionit, kështu që ju lutem mos hezitoni ta përdorni fjalën “evolucion” në këtë mësim. Është thelbësore për të krishterët të njohin rrëfimin e krijimit të Perëndisë dhe mëkatit fillestar të Zanafilla, për të dalluar dhe kuptuar ndryshimet mes teorisë së evolucionit dhe ngjarjes së vërtetë të universit të krijuar. Qëllimi ynë gjatë këtyre tre mësimëve të para është që t’i ndihmojmë nxënësit:

- të kuptojnë atë që thotë Perëndia për mënyrën se si u formua bota;
- të shohin se teoria e evolucionit kundërshton Biblën;
- të besojnë me siguri se Perëndia e krijoi botën;
- të kuptojnë se si mëkati hyri në botë, dhe të kuptojnë nevojën tonë për Shpëtimtarin.

## Ide krijuese për mësimin biblik:

1. Merr me vete nga një objekt që tregon për secilën nga ditët e krijimit dhe vendosi në shtatë çanta të ndryshme. Kërkoju nxënësve t’i shohin dhe t’i prekin objektet që t’i ndihmojnë të kujtojnë mësimin. Ja disa ide: syze dielli për të treguar diellin, ujë në një shishe të tejdukshme, pambuk ose re e prerë nga një letër e bardhë, rërë për të treguar për tokën e thatë, një gjethe për pemët, një pendë për zogjtë, një peshk plastik për krijesat e detit, kafshë plastike, një kukull e vogël dhe një jastëk i vogël për të përfaqësuar pushimin.
2. Vizato në pjata plastike diçka që përfaqëson secilën ditë të krijimit (mos e shkruaj ditën). Ndërsa jep mësimin, vendosi pjatat me radhë. Pas mësimit, hiqi vizatimet. Ndaje klasën në skuadra dhe jepi secilës skuadër një set me pjata. Le të garojnë për të parë se cila skuadër i vendos ditët e krijimit sipas radhës më shpejt. Nëse keni kohë, përsëriteni garën.

3. Zbukuroje derën e klasës dhe vëri një letër ku shkruhet “Makinë kohe”. Lejoji nxënësit që imagjinata t’i kthejë pas në kohë ndërsa hyjnë në klasë.
4. Krijò versionin miniaturë të “Kopshtit Eden” në një akuarium. Përdore akuariumin këtë javë dhe gjatë dy javëve të ardhshme.

## NISU!

### Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtuësit e adhurimit do t’i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

### Koha e zbulimit: E planifikuar me hollësi!

**Qëllimi:** T’i ndihmojmë nxënësit të shohin dhe kuptojnë **hollësirat** e krijimit të Perëndisë.

### Alternativa 1 (për të gjithë nxënësit)

Krijò një kopsht zoologjik brenda ose jashtë. Cakto vullnetarë që të bëhen kafshë specifike, duke dhënë fakte argëtuese për mënyrën se si këto kafshë u krijuan në mënyrë unike nga Perëndia. Kërkoju nxënësve t’i vizitojnë kafshët gjatë *Kohës së zbulimit*, duke u përqendruar në **hollësirat** unike të kafshëve.

### Alternativa 2 (për grupe specifike)

#### Aktiviteti 1: Trotuari jashtë ose hapësirë e madhe brenda

**Mjetet:**

- Shkumës
- Etiketa shpërblyese
- Tabak (nëse po e zhvillojnë aktivitetin brenda)

**Udhëzime për ambientin:** Ndaje trotuarin ose letrën e madhe (tabakun) në zona të caktuara për secilin grup. Në secilën prej zonave të caktuara, shkruaj fjalët: “Shiko çfarë bëri Perëndia!”

#### **Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:**

1. Ndaji nxënësit në dyshe ose në skuadra të vogla.
2. Sfidoji skuadrat të vizatojnë sa më shumë kafshë përreth frazës “Shiko çfarë bëri Perëndia!”
3. Skuadra që ka vizatuar kafshët me më shumë **imtësi**, do të fitojë nga tri etiketa shpërblyese për secilin nxënës.
4. Pasi të ketë përfunduar sfida, kërkoju nxënësve të shohin kafshët e ndryshme që ka bërë Perëndia.

## Aktiviteti 2: Hapësirë e madhe

### **Mjetet:**

- Kafshë të vogla prej lodre që fëmijët të mund t'i shohin si: zogj, qen, mace, peshq, hardhuca etj.
- Lupë zmadhuese
- Lapsa dhe letra
- Etiketa shpërblyese

### **Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:**

1. Ndaji nxënësit në dyshe.
2. Sfidoji partnerët të garojnë për të parë se cila dyshe mund të japë më shumë hollësira të secilës kafshë. Sfidoji t'i përdorin të gjitha shqisat.
3. Kur të përfundojë sfida, diskutoni hollësitat e krijimit të Perëndisë me nxënësit.
4. Shpërble skuadrën fituese me tri etiketa shpërblyese.

**Aktiviteti 3: Stacioni i misionit** - *Mësimi i misionit gjendet në dosjen e kurikulës së vitit të 1-rë, tremujori i 1-rë.*

## **Prezantimi i mësimin nga Bibla**

**Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin:** Gjatë aktivitetit të KZ-së, ju u sfiduat të mendonit për disa nga kafshët në botë. A e keni menduar ndonjëherë se si e krijoi Perëndia secilën prej kafshëve në një mënyrë të veçantë, me kaq shumë imtësi? Perëndia jo vetëm që krijoi të gjitha kafshët (dhe bimët), por Ai krijoi të gjithë botën tonë. Ai është i mrekullueshëm! Sot do të udhëtojmë te fillimi i Biblës për të zbuluar se si Perëndia e krijoi botën.

**Shënim:** Nëse në KZ keni zhvilluar mësimin e misionit, ju lutem theksoni se misionarët shpesh udhëtojnë në pjesë të tjera të botës, ku shohin shumë krijesa të mrekullueshme që Perëndia ka krijuar, siç janë kafshët, bimët apo peizazhet e ndryshme.

**Lutu:** Inkurajo njërin nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje. Kjo do t'i ndihmojë të mësojnë të lutën kur ka njerëz dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre drejtuese frymërore. Nëse nxënësit në klasën tënde nuk duan të lutën, shpjegoju se është nder të drejtosh klasën në lutje, dhe pastaj jepu shembullin duke bërë një lutje të shkurtër.

**Zbuloje:** Ku do të mund të gjeni më shumë informacion të hollësishëm në Bibël për mënyrën se si Perëndia krijoi botën? (Te Zanafilla). A është Zanafilla në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re (DH.V.)? Le t'i hapim Biblat në faqen e parë, libri i Zanafillës, kapitulli një. *Nxënësit më të vegjël dhe vizitorët mund të kenë nevojë për ndihmë. Kjo mund të jetë hera e parë që disa prej tyre hapin Biblën. Nxënësit më të rritur mund të përdorin metodën “Stërviçja me shpata”.*

Çfarë është “Stërvitja me shpata?” Si mësues, ti thua: “Biblat lart!”. Krahët e nxënësve duhet të ngrihen lart me Biblat drejtuar nga tavani. Pastaj ti thua librin, kapitullin dhe vargun. Nxënësit duhet të përsërisin pas teje. Pasi të gjithë nxënësit të kenë përsëritur librin, kapitullin dhe vargun, ti thua: “Nisu!”. Nxënësi i parë që gjen referencën, fiton një etiketë shpërblyese.

**Kronologjia:** Përdor kronologjinë e Biblës për të treguar periudhat kohore ndërsa prezanton mësimin. Do të shkojmë në fillim fare këtë tremujor. Fjala “zanafillë” do të thotë “fillim” dhe libri i Zanafillës na tregon për fillimin, atëherë kur Perëndia krijoi botën.

**Prezantim me tremujorin dhe mësimin nga Bibla:** Si e di ti që Bibla është e vërtetë? Para se të nisim këtë mësim, duhet të kujtojmë se mund t’i besojmë asaj që Bibla na thotë për Perëndinë, për ne dhe për botën rreth nesh. Mund të jemi të sigurt se ajo është e vërtetë, për shkak se ka prova historike, për shkak se Bibla është e mbushur me profeci dhe për shkak se Perëndia thotë që ajo është e vërtetë.

## Përvijimi i Shkrimit: Zanafilla 1:1 – 2:3

### Perëndia fillon

**Lexo: Zanafilla 1:1**

**Përmbledhje:** Bibla na thotë se Perëndia krijoi botën, por a e ke pyetur ndonjëherë veten: “Kush e krijoi Perëndinë?”. Kjo është një pyetje shumë e mirë dhe Bibla na e jep përgjigjen. Bibla thotë se Perëndia është i përjetshëm – përjetësi do të thotë *përgjithmonë*. Është një lloj rrethi; nuk ka as fillim as fund. Perëndia nuk u krijua dhe Ai nuk ka as fillim as fund. Ai ka qenë gjithmonë dhe do të jetë gjithmonë. A nuk është kjo diçka fantastike? Le të shohim se çfarë ndodhi ditën e parë.

### Dita e parë

**Lexo: Zanafilla 1:2-5**

**Përmbledhje:** Çfarë krijoi Perëndia në ditën e parë? (Dritën.) Dhe si e quajti atë dritë? (Ditë.) Dhe si e quajti errësirën? (Natë.) Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar dritën? (Ai tha se ishte mirë.) Cilat ishin dy pjesët që përbënin një ditë? (Një mbrëmje dhe një mëngjes.) Le të shkojmë te dita e dytë.

### Dita e dytë

**Lexo: Zanafilla 1:6-8**

**Përmbledhje:** Çfarë krijoi Perëndia në ditën e dytë? (Qiellin.) Si e krijoi Perëndia qiellin? Ai ndau ujërat. Ujërat e lëngshëm u formuan në Tokë, ujërat e avulluar formuan retë dhe hapësira mes tyre u quajt “qiell”. A nuk është e mrekullueshme sa i fuqishëm është Perëndia? Le të lexojmë për ditën e tretë.



## Dita e tretë

### **Lexo: Zanafilla 1:9-13**

**Përmbledhje:** Cila ishte gjëja e parë që Perëndia krijoi në ditën e tretë? (Ai krijoi tokën dhe detet.) Cilën fjalë përdori Perëndia për të përshkruar tokën dhe detet? (Mirë.) Çfarë krijoi Perëndia në ditën e tretë pas tokës dhe deteve? (Bimësinë.) “Bimësia” u referohet të gjitha bimëve, përfshirë edhe pemët. A krijoi Perëndia lloje specifike bimësh? (Po.)

Kur mendon për të gjitha llojet unike të bimëve që ka në botë, a nuk të bën të mendosh se sa krijues është Perëndia ynë? Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar bimësinë? (Mirë.) Tani le të shohim ditën e katërt.

## Dita e katërt

### **Lexo: Zanafilla 1:14-19**

**Përmbledhje:** Çfarë krijoi Perëndia në ditën e katërt? (Diellin, hënën dhe yjet.) Ku e vendosi Perëndia diellin, hënën dhe yjet? (Në qiell.) A mendon ndonjëherë sa i madh duhet të jetë Perëndia për ta vendosur diellin, hënën dhe yjet në qiell? A e kupton se dielli, hëna dhe yjet ndajnë ditën nga nata? Ato janë shenja që masin periudhat e kohës: stinët, ditët dhe vitet. Ato sjellin dritë në tokë. Cilën fjalë përdori Perëndia për të përshkruar diellin, hënën dhe yjet? (Mirë.)

**Nxënësit më të rritur:** A kishte dritë para se Perëndia të krijonte diellin, hënën dhe yjet? (Po.) Shih Zanafilla 1:3. A kishte ditë dhe natë para diellit, hënës dhe yjeve? (Po.) Shih Zanafilla 1:5. A e di se Zbulesa 22:5 na tregon se si do të jetë qielli? Thuhet: “Dhe natë nuk do të ketë atje; edhe nuk kanë nevojë për llambë, as për dritë dielli, sepse Zoti Perëndi i ndriçon; dhe do të mbretërojnë në jetë të jetëve.” Perëndia do të jetë drita jonë në qiell!

**Të gjithë nxënësit:** Le të kalojmë në ditën e pestë.

## Dita e pestë

### **Lexo: Zanafilla 1:20-23**

**Përmbledhje:** Çfarë krijoi Perëndia në ditën e pestë? (Krijesat e detit dhe zogjtë.) Kur mendon për të gjitha llojet e ndryshme të krijesave të detit dhe për zogjtë, a nuk është e mrekullueshme se me sa imtësi veproi Perëndia kur i krijoi të gjitha këto krijesa? Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar krijesat e detit dhe zogjtë? (Mirë.) Çfarë donte Perëndia që të bënin krijesat e detit dhe zogjtë? (Të rriteshin në numër për të mbushur detet dhe tokën.) Tani erdhi koha për ditën e gjashtë.

## Dita e gjashtë

### **Lexo: Zanafilla 1:24-25**

**Përmbledhje:** Cila ishte gjëja e parë që krijoi Perëndia në ditën e gjashtë? (Krijesat e tokës – siç pamë sot gjatë KZ-së.) A bëri Perëndia lloje specifike të krijesave të tokës? (Po.) Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar krijesat e tokës? (Mirë.)

**Lexo: Zanafilla 1:26-27**

**Përmbledhje:** Cila ishte gjëja e dytë që krijoi Perëndia në ditën e gjashtë? (Njerëzit; mashkull dhe femër). Çfarë ishte kaq e veçantë në mënyrën si Perëndia krijoi njeriun? (Ai e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij.)

**Nxënësit më të mëdhenj:** Përse mendoni se Perëndia tha: “Le ta bëjmë sipas shëmbëlltyrës sonë?” (Triniteti: Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Frymë e Shenjtë – të tre ishin në krijim!)

**Të gjithë nxënësit:** Perëndia i dha njeriut një punë, të sundonte mbi krijesat e detit, mbi zogjtë dhe krijesat e tokës. Kjo do të thotë se ne nuk jemi të barabartë me kafshët. Ne jemi ndryshe – ne jemi bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë.

**Lexo: Zanafilla 1:28-31**

**Përmbledhje:** Çfarë donte Perëndia që të bënin njerëzit? (Të shtoheshin dhe të mbushnin tokën.) Perëndia gjithashtu na dëshi mjaftueshëm, sa na dha ushqim përmes pemëve frytmbajtëse dhe bimësisë. Perëndia i kishte planifikuar hollësisht, përfshirë se çfarë do të hanin kafshët dhe zogjtë. Çfarë fjale përdori Perëndia për të përshkruar gjithçka kishte bërë? (Shumë mirë.)

Uau! A nuk është Perëndia aq i dashur, që krijoi një vend të jashtëzakonshëm ku ne të jetonim? Le të shohim çfarë bëri Perëndia më pas.

**Dita e shtatë**

**Lexo: Zanafilla 2:1-3**

**Përmbledhje:** Çfarë krijoi Perëndia në ditën e shtatë? (Asgjë.) Perëndia bëri diçka shumë të veçantë: Ditën e shtatë, Ai pushoi.

**Nxënësit më të mëdhenj:** A kishte nevojë Perëndia të pushonte për shkak se ishte i lodhur? (Jo.) Atëherë çfarë kuptimi ka fakti që Ai pushoi? (Do të thotë se Ai u ndal së krijuari gjëra të reja.) Si e bëri Perëndia ditën e shtatë të veçantë? (Ai e bekoi dhe e bëri të shenjtë.) Çfarë do të thotë “e shenjtë”? (E shenjtë do të thotë “e ndarë veçmas për Perëndinë”.)

## Përfundimi

Mendo për çfarë ka krijuar Perëndia: diellin, hënën dhe yjet në qiell, tokën, oqeanet, lulet e bukura, pemët madhështore, kafshët dhe ne! Mund të shohim të gjitha hollësisht e gjithçkaje në botën tonë të mrekullueshme dhe të kuptojmë se ka një Krijues, dhe se Krijuesi është Perëndia. Ne mund të shohim çfarë ka bërë Ai dhe të besojmë në Të. Krijimi vërteton se Perëndia ekziston dhe se Ai na do!

## Vepro si duhet dhe Ndiu si duhet

**Nxënësit më të rritur:** *Bëni aktivitetin “Stërvitja me shpata” për të gjetur Hebrenjve 11:3. Kërkoji dikujt ta lexojë me zë të lartë para klasës.*

**Të gjithë nxënësit:** A është e rëndësishme të dimë se Perëndia e krijoi botën siç thuhet te Zanafilla? (Po!) Edhe nëse nuk i dimë të gjitha hollësisht e mënyrës se si Perëndia i plotfuqishëm e bëri botën, mund të zgjedhim të besojmë se Ai e bëri. Bibla na thotë se është e pamundur t'i pëlqejmë Perëndisë nëse nuk kemi besim (Hebrenjve 11:6). Ndoshta mësuesit e tu në shkollë ose miqtë e tu duan që ti të besosh diçka tërësisht ndryshe, si për shembull që bota u krijua aksidentalisht. Por tani që ti e di të vërtetën nga Bibla, mund të zgjedhësh të besosh që Perëndia e krijoi botën, siç thotë Ai thotë te Zanafilla. Le ta themi Zanafillën 1:1 si klasë. *Recitojeni vargun bashkë.* Tani, le t'i mbyllim sytë dhe ta themi sërish, dhe pastaj të ndalemi për ta falënderuar personalisht Perëndinë që është një Krijues i mrekullueshëm.

E di cila është një nga arsyet për t'u gëzuar që Perëndia e krijoi botën? Fakti që do të thotë se Ai të do shumë. Ai e bëri këtë botë që ti ta shijosh dhe të mund të jetosh për Të. Ne pamë disa nga hollësisht e Perëndisë sot. A e di që Ai ka një plan të hollësishëm për jetën tënde tani deri në përjetësi (faqja e artë në Librin pa fjalë)? Perëndia ynë që krijoi gjithë universin, të do shumë. Ai dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdiste si ndëshkim për mëkatin tënd (faqja e zezë) në kryq (faqja e kuqe). Por Perëndia të do aq shumë, saqë të jep ty zgjedhjen për të besuar ose jo në Të. Nëse beson në Jezusin që të të falë mëkatin dhe e bën udhëheqësin e jetës sate, Ai mund ta pastrojë mëkatin tënd dhe ti mund të jesh i shpëtuar e të bëhesh pjesë e familjes së Perëndisë (faqja e bardhë). A të kujtohet çfarë do të thotë përjetësi? Do të thotë *përgjithmonë*. Edhe pse trupi yt nuk do të funksionojë më një ditë, do të jetosh në qiell përgjithmonë me Perëndinë. A je lutur e i ke thënë Perëndisë se beson që Jezusi do të marrë mëkatin tënd dhe se e ke bërë Udhëheqësin e jetës sate? Nëse jo, mund ta bësh tani.

**Të flasësh për Zanafillën me lëvizjet e duarve:**

- **Krijimi:** ngrini duart lart për të formuar botën

*Shënim: Çdo javë shtohet nga një lëvizje e re. Është e rëndësishme ta rishikojmë çdo javë, që në fund të tremujorit studentët të mund “të flasin për Zanafillën” me siguri.*

## **Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?**

*Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.*

1. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e parë dhe të dytë? (Dritën dhe qiellin.)
2. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e tretë? (Tokën, detet dhe bimësinë.)
3. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e katërt? (Diellin, hënën dhe yjet.)
4. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e pestë? (Krijesat e detit dhe zogjtë.)
5. Çfarë krijoi Perëndia në ditën e gjashtë? (Krijesat e tokës dhe njerëzit.)
6. Çfarë bëri Perëndia në ditën e shtatë? (Ai pushoi së punuari, bekoji ditën dhe e bëri të shenjtë.)
7. A e beson se Perëndia e krijoi tokën, ashtu si tha te Zanafilla, pavarësisht gjithçkaje? Përse po ose jo?
8. Si ndikon te mënyra si ti e shikon veten dhe të tjerët të diturit se Perëndia i krijoi njerëzit?